



Pranuar / Dorezuar Prilimjen / Prodato Received / Delivery	06.09.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Pyllog Appendix	Sasia Kolicime Quantity
SKINSHKCK	5998	2023	1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1062/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë -anëtarë, me Vjollca Sinani - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1062/2023 të datës 07.08.2023 të ankuesit me adrese banimi: , në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 05.09.2023, mori këtë.

V E N D I M

I.Refuzohet si e pabazuar ankesa me A.nr.1062/2023 të datës 07.08.2023 e parashtruara nga ankuesi

II.Mbetet në fuqi Vendimi i Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë -Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme me nr.10/2023 të datës 19.07.2023.

Arsyetim

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga shkresat e lëndës ka konstatuar se Ministria e Punëve të Brendshme me datë 05.05.2023 ka shpallur konkursin për grupin Specialistë të Arsimit respektivisht për titullin e pozitës "Inspektor i Arsimit-SIA-Gjakovë" me numër reference RN00011612, katër pozita, ku afati për aplikim ka qenë nga data 26.05.2023 deri më datë 05.06.2023.

Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi Bajram Salih, mirëpo sipas Vendimit me Nr.10/2023 të datës 10.07.2023 i është refuzuar aplikacioni me numër të kodit RAN0014994 të datës 02.06.2023 me arsyetim se nuk i ka dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara në konkurs, ndërsa ndaj të njëjtit

vendim ankuesi kishte parashtruar ankesë në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik - Divizionin për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, i cili departament/divizion më datë 19.07.2023 përmes vendimit Nr.10/2023 kishte refuzuar ankesën si të pabazuar.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr.10/2023 të datës 19.07.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë -Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme, përmes postës më datë 03.08.2023 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 07.08.2023 dhe është regjistruar nën shenjen A.nr.1062/2023 me numër protokoll 5556/2023 me pretendimet ankimore se është konstatuar gabimisht gjendja faktike dhe janë shkelë dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative përkatësisht neni 48 i këtij ligji.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, e ka proceduar me datë 10.08.2023 kërkesën për përgjigje në ankesë te Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministria e Punëve të Brendshme. Ndërsa Këshilli me datë 16.08.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 5556/2023 e datës 07.08.2023 të parashtruar në Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Certifikatë e lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjakovë PN.NR/KR.Br.10514/2022 e datës 30.11.2022; Njoftimi i listës së ngushtë e kandidatëve e datës 06.01.2023; Njoftimi për plotësim ndryshimin e listës së ngushtë të kandidatëve e datës 24.01.2023; Certifikatë mbi dënimet penale nga Këshilli Gjyqësorë i Kosovës e datës 12.07.2023; Vendimi me nr.10/2023 të datës 10.07.2023; Ankesë e datës 12.07.2023; Vendimi me nr.10/2023 të datës 19.07.2023; Përgjigja në ankesë e datës 16.08.2023; Lista e Aplikantëve; Vendimi me nr.05/151 të datës 12.07.2023; Konkurs i datës 05.05.2023; Njoftim i datës 19.07.2023 nga DMZP-MPB; Njoftim i datës 10.07.2023 nga DMZP-MPB; Vendimi me nr.10/2023 të datës 19.07.2023; Aplikacioni i Ankuesit; Diploma e Masterit e datës 21.02.2014 me nr.04/14 e ankuesit; Diploma e Masterit e datës 28.02.2020 me nr.646 e ankuesit; diplomë e universitetit bazë Baçelor e datës 30.01.2016 me nr.389/2016 e ankuesit; Certifikatë nga MASHT, dhjetor 2019; Certifikatë nga MASHT, Prishtinë 2018; Certifikatë nga MASHT, Prishtinë 2017; Certifikatë nga MASHT nga data 19-21.05.2017; Certifikatë nga MASHT nga data 29-30.03.2017; Certifikatë nga Shoqata e mësimitdhënësve të historisë së Kosovës nga data 02-04.12.2016; Certifikatë nga MASHT e datës 24.04.2016; Certifikatë nga USAID, shtator 2014; Certifikatë nga REC e datës 03.12.2013; Licencë e mësimitdhënies me nr.100007962; Certifikatë nga MASHT nga data 07-09.10.2011; Certifikatë nga MASHT, Mars 2016; Deklaratë e ankuesit e datës 06.12.2022; Kopja e Letërnjoftimit të ankuesit; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021; Vërtetim me nr.1449 i datës 06.12.2022; Vërtetim i marrëdhënies se punës i datës 06.12.2022; Vërtetim për masë disiplinore e datës 06.12.2022; Trusti i datës 25.05.2023; Certifikatë e lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës e datës 01.06.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Kolegji i Këshillit, konstaton së në konkursin Nr.Reference: RN00011612 për grupin Specialistë të



Arsimit respektivisht për titullin e pozitës “Inspektor i Arsimit-SIA-Gjakovë” me numër reference RN00011612, katër pozita, kriteret e përgjithshme formale kanë qenë:

- *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/ a e arsimit të lartë me së paku 3 vite të studimeve*
- *Licencë e mësimdhënësit të kualifikuar në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës;*
- *Përvoja e punës: Se paku dy (2) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë së lirë të punës, me theks të veçantë, përvojë pune në mësimdhënie.*

Ndërsa pikën 7 të këtij konkursi si dokumentacion që duhet paraqitur për aplikim janë: *Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, nostrifikimi për diplomat e marra jashtë vendit; Kopje e dëshmisë së punësimit të cilave u bashkëngjitet se paku njëra nga dëshmitë mbështetëse si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale; Kopjet e dëshmisë së trajnimeve; Certifikatë/vërtetimi nga Gjykata ose nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës me të cilën dëshmohet se nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit. Nëse kohëzgjatja lidhur me përvojë e kërkuar e punës, është në sektorit publik atëherë është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati/ja me të cilën dëshmohet se ai/a jo nuk gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 8 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.6) të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë”.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se në konkursin e datës 05.05.2023 të shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme për grupin Specialistë të Arsimit respektivisht për titullin e pozitës “Inspektor i Arsimit-SIA-Gjakovë” me numër reference RN00011612, katër pozita, ka aplikuar edhe ankuesi [redacted] me aplikacionin me numër kodi RAN0014994, ndërsa me datën 10.07.2023 përmes Vendimit me numër 10/2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik -Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, ankuesit i është refuzuar aplikacioni për shkak se i njëjti nuk i ka dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara me konkurs, specifikisht nuk ka bashkëngjitur Certifikatën/vërtetim nga Gjykata ose nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës me të cilën dëshmohet se i njëjti nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë muaj nga data e lëshimit ashtu si është kërkuar në konkurs ndërsa certifikatën e dorëzuar me rastin e aplikimit e datës 01.06.2023 vërteton se jeni i dënuar me aktgjykim të formës së prerë Nr P-3113/2014 të datës 05.01.2018 për Vepër Penale.

Ndaj të njëjtit vendim ankuesi me datë 12.07.2023 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik-Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme me pretendimin se është i bindur se me rastin e aplikimit ka bashkëngjitur certifikatën se nuk është i dënuar e gjeneruar përmes platformës E-Kosova dhe se nga siguria se nuk ka ushtruar ndonjë vepër penale e ka ngarkuar në sistem duke mos e vërejtur përmbajtjen e së njëjtës. Tutje, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik-Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme përmes Vendimit me nr.10/2023 të datës 19.07.2023 ka refuzuar ankesën si të pabazuar me arsyen se ankuesi nuk ka ofruar dëshminë e kërkuar sipas konkursit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në kuptim të përmbajtjes së objektit të kësaj ankese me rastin e vendimmarrjes kishte parasysh kërkesat e përgjithshme formale për pranimin e zyrtarëve publikë të paraparë me nenin 8 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht me paragrafi 1 nën paragrafi 1.5, përcaktohet se: *"1. Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë janë: 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar; 1.3. të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji"*, ndërsa së bashku me aplikacion kandidatët duhet të dorëzojnë kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurrimit dhe me kriteret e cekura si më lartë e që janë kërkesa edhe sipas nenit 12 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e konkurimit, kandidatët duhet të bashkangjiti edhe dokumentacionin si në vijim: 2.1. kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit, dhe 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurimit dhe të deklaruara në aplikacion"*, rrjedhimisht ankuesi me rastin e aplikimit nuk ka bashkangjitur të gjitha dokumentet e kërkuara me konkurs, specifikisht ankuesi nuk ka bashkangjitur Certifikatën nga Gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit ashtu si ishte paraparë në konkurs, po ashtu Kolegji i Këshillit ka analizuar edhe dispozitat nenit 15 paragrafi 5 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës ku thuhet; *"Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se katërmëdhjetë (14) ditë kalendarike nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve"* dhe lidhur me nenin 10 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2 ku thuhet se: *"Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen"* dhe si i tillë Vendimi me nr.10/2023 i datës 19.07.2023 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme është i drejtë dhe i ligjshëm, sepse i njëjti është nxjerr në frymën ligjore dhe mbi bazë të gjendjes faktike dhe duke u respektuar kompetenca dhe hierarkia ligjore e përcaktuar me nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5, nenin 34 paragrafi 7 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 12 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2, nenin 15 paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe se i njëjti është i arsyetuar në pajtim me dispozitat e nenit 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, nga konstatimi si më lartë, thekson faktin se me vendimin e kundërshtuar me ankesë, ankuesit nuk i është cenuar asnjë e drejtë nga e drejta për t'iu nënshtruar procedurave të tjera të pranimit ngase obligimi për të dorëzuar dokumentacionin së bashku me aplikacionin është obligim i kandidatit e jo institucionit, ri rezultat i kësaj Kolegji i Këshillit konstaton se të gjitha pretendimet e ankuesit janë të pabazuar për shkak që nuk gjejnë mbështetje ligjore.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1062/2023, datë 05/09/2023

Vjollca SINANI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesi;
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

